



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:156052  
Datë: 11.12.2024  
Numri i dokumentit: 06582177

Rev.nr.551/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Mr.sc. Muhamet Rexha dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Y. F. nga P., rr. "...", numër ... në P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Venhar Hana - avokat në P., kundër të paditurës Telekom i Kosovës, Sh.A me seli në P., të cilin e përfaqëson R. Xh., me objekt të padisë anulimi i vendimit dhe ndryshimi e gradës, duke vendosur sipas revizionit të paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4143/2024, datë 05.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 09.12.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si i pathemeltë revizioni i paditësit Y. F. nga P., rr. "...", numër .. në P., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4143/2024, datë 05.02.2024.

**A r s y e t i m i**

Me dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4143/2024, datë 05.02.2024, është vendosur që të refuzohet ankesa paditësit Y. F. nga P., rr. "...", numër .. në P., ndërsa, vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.4909/2020, i datës 20.04.2022, me të cilin "I. Refuzohet e pabazuar bazuar kërkesëpadinë e paditësit Y. F. nga P. me të cilën ka kërkuar që të anulohet Vendimi i Bordit të përkohshëm të drejtorëve i dt. 12.05.2020, për uljen e pagave të stafit të Telekomit të Kosovës dhe të detyrohet e paditura Telekom i Kosovës sh.a me seli në P., që paditësit t'ia ndryshoj gradën e kompensimit nga 6 në gradën 11 dhe t'ia kompensoj pagën e plotë sipas nivelit të gradës përkatëse për vendin e punës; të detyrohet e paditura që paditësit në emër të ndryshimit të pagës ndërmjet gradës 6 dhe 11, t'ia paguaj shumën në emër të pagave të

papaguara neto në lartësi prej 14,707.24€, në emër të trustit pensional shumën prej 860.07€, në emër të tatimit në të ardhurat personale shumën prej 1,634.14€, e në shumë të përgjithshme prej 17,201.47€; në emër të zvogëlimit të pagës prej 10% shumën neto prej 2,319.20€ për periudhën nga data 15.05.2020 deri me datën 22.03.2022, si dhe kontributet pensional në shume prej 131.52 €, për të njëjtën periudhë; të gjitha këto ne kamate ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës ne shume prej 1,226.80€. Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.”

Kundër aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi, përmes të autorizuarit, avokat Venhar Hana nga P., në afat ligjor, ka paraqitur revizion për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet revizioni, aktgjykimet e instancave më të ulëta të prishen dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim, ose që aktgjykimet e cekura të ndryshohen dhe të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditëit.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjyqimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

Revizioni i paditësit është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datën 11.11.2020, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për anulimin e vendimit të Bordit të drejtoreshave dhe ndryshimin e gradës së punës nga grada 6 në gradën 11, si dhe kompensimin e ndryshimit të gradës, me arsye sikurse në padi për periudhën nga data 15.05.2020 deri me datën 22.03.2022.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët, siç janë: Kontrata e punës për kohë të pacaktuar me nr..... i datës 02.09.2015; Aktvendimi mbi ri sistemimin e punëtorit me nr. .... i datës 26.06.2019, lexohet kërkesa për harmonizimin e gradës dhe mos diskriminim me nr. .... i datës 17.09.2020; E-maili me titull “Njoftim” drejtuar të paditësës nga Komisioni i ankesave i datës 12.10.2020; Kërkesa- pëlqimi për ri sistemim i punëtorit- paditësit drejtuar Drejtorit të burimeve njerëzore të TK Sh.A; Vendimi me nr. .... i datës 14.10.2021 për revokimin e vendimit nr. .... i datës 26.06.2019; Kontrata e punës për kohë të pacaktuar me nr..... i datës 14.10.2021; Procesverbali nga mbledhja nr.... i datës 12.05.2020 i BPD-TKSHA, me nr. .... i datës 15.05.2020; Ekstrakti nga mbledhja nr... i datës 22.05.2020 i BPD-TKSHA me nr.... i datës 22.05.2020; Ekspertiza financiare e datës 22.03.2022 dhe plotësimi i ekspertizës financiare i datës 08.04.2022 ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.4909/20, të datës 20.04.2022, me të cilën ka vendosur që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pabazuar.

Në arsyetim të aktgjykimit, ndër të tjera gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk është kontestuese se paditësi është duke punuar tek e paditura sipas Kontratës së punës me kohë të pacaktuar me nr. .... e dt. 14.10.2021, në cilësinë e ....., me gradën 6. Më tej nuk është kontestuese as që paditësi ka kërkuar që të anulohet Vendimi i Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve i dt. 11.05.2020 mbi uljen e pagave të gjithë stafit të Telokomit të Kosovës, ndonëse sipas dispozitës së nenit 79 të Ligjit të punës paditësi nuk ka kërkuar mbrojtje të brendshme tek e paditura, përkatësisht nuk i ka shfrytëzuar mjete e brendshme juridike tek e paditura. Nuk është kontestuese që e paditura me Aktvendimin për ri sistemimin e punëtorit nr. ...., i datës 26.06.2019, paditësi është risistemuar në cilësinë e ..... me koeficient 6. Kundër këtij aktvendimi paditësi nuk ka paraqitur ankesë, në Komisionin e ankesave të paditurës. Përkundrazi paditësi ka dhënë pëlqim për t'u risistemuar në këtë vend pune. Po kështu e paditura me vendimin nr. .... i dt. 14.10.2021 ka revokuar vendimin e cituar më lartë dhe paditësi risistemohet në detyruat e punës .... me lartësi të gradës 6. Kundër këtij vendimi paditësi nuk ka paraqitur ankesë në Komisionin e ankesave të paditurës. Përkundrazi paditësi me të paditurën nënshkruajnë Kontratën e punës për kohe të pacaktuar nr..... i dt. 14.10.2021, të cilën Kontratë ai nuk e konteston. Ka shtuar se janë të pabazuara dhe në kundërshtim me kontratat dhe vendimet e theksuara, pretendimet kur paditësi kërkon diferencën e pagës, prej gradës 6 në gradën 11, në shuma të paguara. Kundër këtyre vendimeve dhe kontratave paditësi nuk ka ushtruar mjetet juridike, por i njëjti shprehimisht është pajtuar, i ka nënshkruar dhe nuk ka paraqitur kurrfarë ankese ndaj tyre. Madje me kërkesën e vet ai është pajtuar për tu sistemuar në pozitën e .... me gradën 6. janë pretendimet e paditësit kur kërkon që në emër të zvogëlimit të pagës prej 10% nga niveli i gradës 11, për periudhën nga dt. 15.05.2020 deri me dt. 20.03.2022, e paditura t', ia paguaj shumën prej 2,319.20€.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës. Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur sipas ankesës kishte gjetur se mbi bazën e gjendjes të vërtetuar faktike, Gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale me referencë në nenin 11 të Ligjit të Punës, sepse sipas kontratës së punës, paga është përcaktuar sipas gradës 6. Gjykata e Apelit e pranon në tërësi qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, pasi që i njëjti vendim është në përputhje të plotë me provat materiale të administruara nga shkalla e parë.

Gjykata e Apelit vlerësoi se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse që kanë të bëjnë me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë. Kjo për faktin se sipas kontratës së punës me kohë të

pacaktuar nr. ...., e datës 02.09.2015, paditësi në cilësinë e punëmarrësit dhe e paditura në cilësinë e punëdhënësit kanë lidhur kontratë për pozitën e .... në Departamentin e Burimeve Njerëzore dhe Administratë, ku paditësit në këtë rast punëmarrësit i caktohet paga për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në lartësi të gradës 6. Ndërkohë, paditësit, me aktvendimin për ri sistemimin e punëtorit nr. .... i datës 26.06.2019, e paditura e ka risistemuar në punë dhe e ka angazhuar në cilësinë e ..... prej datës 26.06.2019, me koeficient 6, mirëpo kundër këtij aktvendimi, rezulton se paditësi nuk ka paraqitur ankesë në Komisionin e ankesave tek e paditura, por ka bërë kërkesë për harmonizim të gradës, ndërsa sipas formularit të kërkesës /pëlqimit për ri sistemim rezulton se paditësi ka dhënë pëlqimin për t'u risistemuar nga vendi i punës si .... në .... me koeficient të njëjtë. Po kështu e paditura me vendimin nr. .... i dt. 14.10.2021 ka revokuar vendimin paraprak të tij dhe paditësi rikthehet në detyrat e punës .... në Departamentin e Logjistikës me lartësi të gradës 6 prej datës 13.10.2021 për ta finalizuar pozitën me anë të kontratës së punës në kohë të pacaktuar nr. ...., të datës 14.10.2021, në pozitën .... pozitë të cilën ende e mban. Gjithashtu drejtë e ka konstatuar gjendjen faktike edhe sa i përket përmbajtjes së kontratës së punës të cilën e ka vlerësuar se është në përputhje me dispozitën e nenit 11 të Ligjit të Punës dhe të cilën paditësi vullnetarisht ka themeluar marrëdhënie punë me të paditurën duke paraparë kushtet, detyrat dhe përgjegjësitë e secilës palë kontraktuese, pra përfshirë edhe gradën e pagesës.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallë së dytë, pasi që aktgjykimi nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykatat e instancës më të ulët drejtë kishin vlerësuar pretendimin e palës paditëse lidhur me diskriminim të paditësit për arsye se i njëjti ka nënshkruar kontratat e punës sipas gradës 6 dhe jo sipas gradës 11, pasi që me rastin e lidhjes së kontratës së punës nr..... i datës 02.09.2015, paditësi në cilësinë e punëmarrësit dhe e paditura në cilësinë e punëdhënësit kanë lidhur kontratë për kohë të pacaktuar ku paditësit, në këtë rast punëmarrësit, i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në lartësi të gradës 6, ndërsa edhe pas ri sistemimit të vendeve të punës tek e paditura, paditësi ishte risistemuar në vend tjetër të punës por me të njëjtën gradë e po ashtu edhe sipas kontratës së punës me kohë të pacaktuar me nr. 3543/2021 e dt. 14.10.2021, paditësi është angazhuar në cilësinë e ....., me gradën 6, prandaj çfarëdo ngritje të gradës do të mund të bëhej vetëm më pëlqimin dhe pajtimin e dy palëve kontraktuese qoftë përmes aneksit apo ndryshimit të kontratës së punës, ndërsa nuk hyn në kompetencën e gjykatave që të bëjë rregullimin e raporteve në mes punëdhënësve dhe punëmarrësve lidhur me nivelin e pagesës apo gradave.

Gjykata Supreme vlerëson se me nenin 55 par. 1 të Ligjit të punës (Gazeta zyrtare 03-L-212–të RK) është caktuar se i punësuar ka të drejtë në pagë e cila caktohet me kontratë të punës e në pajtim me këtë Ligj, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Paga e paditësit sipas kontratës së punës ka qenë në gradën 15-të dhe ulja nën këtë gradë është në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe ligjin. Kërkesa e aksionarit Qeverisë së Republikës së Kosovës – Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, lidhur me uljen e shpenzimeve operative te e paditura në raport me të hyrat e përgjithshme nuk mund të jetë bazë për uljen e pagës së paditësit pasi që në rekomandimin e Qeverisë nuk janë precizuar se cilat shpenzime operative e as që thuhet për uljen e pagave dhe se e paditura është dashur ta paraqiste një plan të detajuar operativ lidhur me uljen e shpenzimeve duke i precizuar ato, por një provë e tillë nga ana e të paditurës nuk është paraqitur, çka thëniet e revizionit në këtë drejtim janë të pabazuara.

Për faktin se paditësi kishte kontratë valide me gradën 6, kishte dhënë pëlqimin për zvogëlimin e pagave sipas vendimit të aksionarit, Qeveris së Kosovës, edhe tani kishte kontratë me gradën 6 për të cilën edhe paguhej, edhe Gjykata Supreme e Kosovës i refuzon si të pa bazuar këto pretendime të paditësit.

U shqyrtuan edhe pretendimet tjera të përmendura në revizion por u refuzuan sepse me të njëjtat nuk mund të vihet në pyetje aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe të parë, me pretendime të revizionit të cilat ishin përsëritur edhe në shqyrtim edhe në procedurën e ankesës, për të cilat gjykatat kishin dhënë arsyetime adekuate, andaj edhe si të tilla u refuzuan si të pabazuara.

Në revizion, përsëriten thëniet përkitazi me gjendjen faktike, të cilat gjykatat e instancës më të ulët, i kanë vlerësuar dhe për të gjitha këto kanë dhënë arsye në arsyetimin e aktgjykimit. Për më tepër kjo gjykatë shton, se sipas nenit 214.2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, përderisa revizioni në të vërtetë, për këtë arsye i godet aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët duke potencuar se këto aktgjykime janë të bazuara në vlerësimin e gabueshëm të cilat sipas gjykatës së revizionit janë sqaruar në procedurën e shkallës së parë dhe në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë në procedurë sipas ankesës.

Nga sa u tha më sipër Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se nuk ekzistojnë arsytet për të cilat është paraqitur revizioni dhe me zbatimin e nenit 222 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.551/2024, datë 09.12.2024

Numri i lëndës: 2020:156052  
Datë: 11.12.2024  
Numri i dokumentit: 06582177

Kryetari i Kolegjit  
Beshir Islami